




Këshilli Gjyqësor i Kosovës
Sudski Savet Kosova
Kosovo Judicial Council



Këshilli Prokurorial i Kosovës
Tužilački Savet Kosova
Kosovo Prosecutorial Council



Në mbledhjen e përbashkët të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës, të mbajtur me 28 maj 2012, duke u bazuar në nenin 46 të Ligjit mbi Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe nenin 36 të Ligjit mbi Këshillit Prokurorial të Kosovës, të dy Këshillat nxjerrin këtë

RREGULLORE

për mbajtjen e mbledhjes së përbashkët të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës

Neni 1

Thirrja e mbledhjes së përbashkët

1. Mbledhja e përbashkët mund të thirret nga të dy Kryesuesit, të cilët paraprakisht pajtohen rreth orës dhe vendit të mbajtjes së mbledhjes. Kryesuesi i KGJK-së i thërret anëtarët e KGJK-së për mbledhjen e përbashkët dhe Kryesuesi i KPK-së i thërret anëtarët e KPK-së.
2. Kuorumi duhet të jetë i njëjtë siç përcaktohet në ligjet përkatëse – 9 anëtarë nga KGJK-ja dhe 6 anëtarë nga KPK-ja.
3. Kryesuesit e Këshillave do të inkurajojnë të gjithë anëtarët e dy Këshillave të marrin pjesë në mbledhjen e përbashkët.

Neni 2

Kryesimi i mbledhjes së përbashkët

1. Mbledhjen e përbashkët e kryeson kryesuesi me i moshuar i të dy Këshillave.

2. Drejtori i Sekretariatit të KGJK-së dhe ai i KPK-së ofrojnë mbështetjen e nevojshme gjatë takimit të përbashkët, duke siguruar që çdo informacion apo dokument i nevojshëm për takimin t'u dorëzohet me kohë anëtarëve.

Neni 3

Vendimmarrja

1. Vendimi për zgjedhjen apo emërimin e Drejtorit të Zyrës së Prokurorit Disiplinor merret në përputhje me nenin 46, paragrafi 1 i Ligjit mbi KGJK-në dhe nenin 36 të Ligjit mbi KPK nga dy të tretat (2/3) e anëtarëve të përbashkët të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës.
2. Në mbledhjen e përbashkët, Këshillat do të shqyrtojnë propozim rekomandimet e Komisionit Intervistues të themeluar nga të dy Këshillat.
3. Kryesuesi i Komisionit dhe anëtarët tjerë të Komisionit mund të referojnë para anëtarëve të të dy Këshillave lidhur me procesin e rekrutimit dhe kandidatët e propozuar nga Komisioni.
4. Procesi i vendimmarrjes mbi zgjedhjen e kandidatit më të suksesshëm bëhet përmes procedurës së votimit të fshehtë.
5. Procedurën e votimit të fshehtë e udhëheqin dhe monitorojnë Drejtori i Sekretariatit të KGJK-së dhe ai i KPK-së.
6. Duhet të përgatiten fletëvotime ku duhet të jenë të shënuar emrat e kandidatëve të propozuar nga Komisioni Intervistues.
7. Për secilin anëtar të të dy Këshillave duhet të ketë nga një fletëvotim.
8. Drejtori i Sekretariatit të KGJK-së dhe ai i KPK-së sigurojnë që secili fletëvotim duhet të jetë i vulosur me vulën e KGJK-së dhe KPK-së.
9. Drejtori i Sekretariatit të KGJK-së dhe ai i KPK-së sigurojnë një vend të fshehtë ku secilit anëtarë t'i mundësohet një votim i qetë dhe i fshehtë.
10. Anëtarët e dy Këshillave votojnë në atë mënyrë duke shënuar emrin e kandidatit të cilin dëshirojnë ta emërojnë për drejtor të ZPD-së.
11. Fletëvotimet e dëmtuara, me më shumë se një shënjim, apo me gabime konsiderohen të pavlefshme.
12. Drejtori i Sekretariatit të KGJK-së dhe ai i KPK-së gjithashtu sigurojnë një kuti ku do të bëhet votimi.
13. Pas përfundimit të votimit, Drejtori i Sekretariatit të KGJK-së dhe ai i KPK-së hapin kutinë e votimit dhe duke shpalosur secilin fletëvotim me pamje të dukshme nga anëtarët e dy

Këshillave dhe duke regjistruar secilën votë se cilit kandidat i takon. Gjithashtu edhe votat eventuale të pavlefshme regjistrohen.

14. Nëse pas votimit të parë asnjë nga kandidatët nuk merr (2/3) e anëtarësisë së përbashkët të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës, në përputhje me nenin 2 të kësaj rregulloreje, organizohet votimi vetëm për dy kandidatët të cilit kanë marrë më së shumti vota.
15. Nëse gjatë votimit të parë asnjëri nga dy kandidatet nuk merr 2/3 e anëtarësisë së përbashkët të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës, ri votohet edhe një here.
16. Kandidati i cili merr 2/3 e votave të anëtarësisë së përbashkët konsiderohet si kandidati i emëruar në cilësinë e Drejtorit të ZPD-së.
17. Në rast se në mbledhjen e përbashkët të dy Këshillat dështojnë në zgjedhjen e një kandidati, atëherë konkursi duhet të rishpallet
18. I gjithë materiali i procedurës së votimit mbeten në dosjen konfidenciale të kandidatit fitues.

Neni 4

Pjesëmarrja në mbledhjen e përbashkët

Mbledhja e përbashkët është e mbyllur për publikun.

Neni 5

Procesverbali i mbledhjes dhe diskutimeve

1. Të dy drejtorët sigurojnë që mbledhja e përbashkët të incizohet, duke përfshirë përgatitjen e plotë dhe të saktë të procesverbaleve.
2. Procesverbalet nënshkruhen nga të dy Kryesuesit.
3. Procesverbalet e takimit të mbyllur janë konfidenciale, përveç nëse më pas bëhen publike nga të dy Këshillat.
4. Audio-incizimi i mbledhjes së përbashkët ruhet në vend të sigurt nga Sekretariati i KGJK-së së paku tri (3) vite pas nënshkrimit të procesverbalit të mbledhjes nga të dy Kryesuesit.

Neni 6

Gjuhët

Agjenda e mbledhjes dhe materialet duhet të përgatiten në tri gjuhë, gjuhën shqipe, serbe dhe angleze. Mbledhjet do të zhvillohen në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze.

Neni 7

Obligimet e Konfidencialitetit

Pjesëmarrësit në mbledhjen e përbashkët janë të obliguar ta ruajnë konfidencialitetin e çështjeve të diskutuara në takim. Ky parim aplikohet edhe për të gjithë personelin tjetër mbështetës të anëtarëve të Këshillave gjatë atyre mbledhjeve.

Neni 8

Komunikata për media

Drejtorët e të dy Sekretariateve të udhëhequr nga Kryesuesit do ta përpunojnë dhe publikojnë komunikatën për media në bazë të rezultateve të mbledhjes së përbashkët. Komunikata për media do të publikohet në ueb-faqet e të dy Këshillave.

Neni 9


Miratimi dhe hyrja në fuqi

Kjo Rregullore miratohet në mbledhjen e parë të përbashkët të të dy Këshillave dhe hyn menjëherë në fuqi.

Enver Peci,

Kryesues,

Këshilli Gjyqësor i Kosovës



Ismet Kabashi,

Kryetar,

Këshilli Prokurorial i Kosovës

